



Pranuar / Dostuzar Prilbjen / Prodato Received / Delivery	21. 11. 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	H / Prot H / Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	7247/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.875/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri -Zyrtare i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.875/2022 të datës 07.10.2022 të parashtruar nga ankuesi _____ nga _____ ne adresë _____

kundër organit të punësimit Komunës së Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "shkelje e së drejtas së pagës", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 21.11.2022, njëzëri, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet ankesa me numër A.nr.875/2022 e datës 07.10.2022 parashtruar nga ankuesi _____ si e bazuar.

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore-administrative për harmonizimin e koeficientit të pagës së nëpunësit civil _____ nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin tetë (8).

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 07.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5959/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e plotësuar me datë 18.11.2022, kundër Përgjigjes me numër reference 01.120/04-0088856-2/22 e datës 04.10.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës, me pretendimet ankimore për njohjen e të drejtës për harmonizim të

koeficientit të pagës nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin tetë (8) lidhur me titullin e pozitës që ushtron.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 11.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa, kjo e fundit më datë 12.10.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 875/2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ndryshim dhe Plotësimin e ankesës me numër të protokollit 7219/2022 të datës 18.11.2022 ; Vendimin më Nr.05-31-34733 i datës 19.06.2012 të Drejtorit të Drejtorisë në Komunën e Mitrovicës; Kontratën e punës të datës 03.08.2012 në emër të ankuesit; Kërkesën me numër reference: 01-112/02-008443/2018 të datës 10.10.2018 nga Drejtori i Inspektionit; Vendimin me numër reference 01-112/02-0092235-2/18 të datës 05.12.2018 të kryetarit të Komunës së Mitrovicës; ID-Kartela e punës së ankuesit; Autorizimin me numër me numër protokollit: 05-112/02.0036372/20 të datës 03.07.2020; Kërkesën me numër reference 01.120/04-0088856-2/22 të datës 30.09.2022 drejtuar shefit të personelit lidhur me harmonizimin e koeficientit; Përgjigjen me numër 01.120/04-0088856-2/22 të datës 04.10.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës; Raportin e punës për gjashtë mujorin e vitit 2022 nga data 01.01.2022 deri me datën 31.06.2022; Vendimin me numër të protokollit 4376/2022 të datës 08.07.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen me numër 01-120/04-0087580-2/22 të datës 16.09.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës; Vendimin me numër të protokollit 4787/2022 të datës 18.08.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6082/2022 të datës 11.10.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 6110/2022 të datës 12.10.2022; Akt Emërimit me numër të protokollit 01.112/22603 të datës 27.08.2013; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 05.08.2019; Kërkesën me numër 01/120/04-0088856/22 të datës 30.09.2022 lidhur me harmonizimin e koeficientit nga koeficienti i pagës 7.5 në 8.5; Fletedorzimin me numër 01-120/04-0088856-2/22; Listën e pagave për periudhën kohore 01.08.2022 deri me datën 31.08.2022; Listën e pagave për periudhën kohore 01.09.2022 deri me datën 30.09.2022; Kontratën e punës të datës 23.08.2010; Kërkesën e datës 08.10.2019 për ndryshimin e listës së pagave; Vendimin me numër Nr.01-112/02-0092235-2/18 të datës 05.12.2018 të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës; Vendimin me numër Nr.01-112/02-0092235-3/19 të datës 09.10.2019 të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës; Vendimin me numër Nr.05-31-34733 të datës 19.06.2012; Njoftimin me numër 01/34733/2 të datës 04.09.2012; Kontratën e punës të datës 03.05.2012; Vendimin me numër 01-112/2-0092235-3/19 të datës 09.10.2019; Emalin e datës 19.08.2022 me numër të protokollit 6225/2022 të Drejtuar Konkursin e datës 23.09.2022 me numër reference RN00009981 për pozitën "Inspektor për Mbrojtjen e Mjedisit"; Konkursin e datës 23.09.2022 me numër reference; RN00009989 për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike"; Konkursin e datës 19.08.2022 me numër reference; RN00009713 për pozitën "Inspektor i Tregut".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, **SEPSE**:

Nga administrimi i provave materiale rezulton së ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, gjegjësisht sipas Aktit të Emërimit me numër protokolli 01.112.22603 të datës 27.08.2013, i njëjti është emëruar në pozitën *“Inspektor i Komunikacionit”* në Drejtorinë e Inspektionit me koeficient gjashtë (6) të pagës. Ankuesi më datë 30.09.2022 ka parashtruar kërkesën pranë Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut, për harmonizim (ngritje) të koeficientit të pagës nga 7.5 në 8.5 mbi bazën e vendimit me numër 34733 të datës 19.06.2012 me të cilin ankuesi ishte caktuar U.d e Shefit të Sektorit të Transportit Rrugor, në kuadër të Drejtorisë së Inspektionit, ndërsa Menaxheri i Burimeve Njerëzore përmes përgjigjes me numër reference 01-120/04-0087008-2/22 të datë 26.09.2022, ka refuzuar kërkesën e parashtruar nga ankuesi me arsyetim se ankuesi pozitën shefit të sektorit e kishte mbajtur si ushtrues detyre sipas Ligjit Nr.06/L-149 për Shërbim Civil, ku me shfuqizimin e tij përkatësisht Hyrja në fuqi e Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtaret Publikë përben shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënieve të punës me ushtruesit e përkohshëm të detyrës së zyrtarëve. Ushtruesit e detyrës kthehen në vendimin e punës. Rrjedhimisht ankuesi mban pozitën e inspektorit të transportit rrugor sipas Aktit të emërimit të 27.08.2013 kështu që aktualisht në Komunën e Mitrovicës nuk ka inspektor komunal që kanë koeficientin tetë (8), ndërsa shpallja e konkurseve për inspektorë është bërë duke u bazuar në konfirmimin e Departamentit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

I pakënaqur me përgjigjen e organit të punësimit, ankuesi me datë 07.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e plotësuar me datë 18.11.2022, me pretendimin ankimor për harmonizimin e koeficientit të pagës së inspektorit të transportit rrugor nga koeficienti gjashtë (6) në koeficient tetë (8).

Lidhur me pretendimin e ankuesit për harmonizim të koeficientit të pagës për pozitën e Inspektorit të Transportit Rrugor, Kolegji ju referua nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: *“Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave”*, si dhe nenit 3 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë më të cilin parashihet se: *“Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë”*. Andaj, mbi këtë bazë ligjore e nisur nga konstatimi si më lartë se ankuesi është emëruar në pozitën Inspektor Transportit Rrugor me koeficient gjashtë (6) të pagës, si dhe duke u bazuar në shkresën e datës 19.08.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik si organ përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për pagat e zyrtarëve publikë, me të cilin është konfirmuar se pozita inspektor-klasa profesionale 1, ka të përcaktuar koeficientin tetë (8) të pagës, Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimi ankimor i ankuesit për harmonizimin të koeficientit të pagës me titullin e punës është i drejtë dhe i ligjshëm.

Po ashtu, Kolegji ka gjetur se organi i punësimit përkatësisht Komuna e Mitrovicës së Jugut me datë 23.09.2022 ka shpallur Konkursin për inspektorë në kuadër të Drejtorisë së Inspektionit duke përcaktuar koeficient tetë (8) të pagës, rrjedhimisht, sipas provave të lëndës Kolegji gjen së Komuna e Mitrovicës së Jugut ka shpallur Konkursin më numër reference RN00009731 për

pozitën Inspektor i tregut në Drejtorinë e Inspekcionit me koeficient tetë (8), Konkursin me numër reference RN00009981 për pozitën Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit në Drejtorinë e Inspekcionit me koeficient tetë (8), si dhe Konkursin me numër reference RN00009989 për pozitën Inspektor i Shërbimeve Publike me koeficient tetë (8). Kështu që mbi bazën e këtyre fakteve si dhe duke marr parasysh konstatimet si me lartë, Kolegji vlerëson së mos realizimi i pagës së njëjtë për punë të njëjtë paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të ankuesit në raport me zyrtaret që ushtrojnë pozitë të njëjtë të punës apo e ngjashme ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi ku thuhet se: *“Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji. Ndërlidhur me këtë, trajtimi jo i barabartë i zyrtareve publike në kuptim të së drejtës së pagës është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: “1. Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë...” Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimi ankimor i ankuesi për harmonizimin të koeficientit të pagës me titullin e punës është i drejtë dhe i ligjshëm.*

Siç u theksua me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit..

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.875/2022

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

[Signature]
Proçesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.